



**KONTRATE PER KALIMIN E  
KUOTES SE KAPITALIT**

Sot, me 25 Tetor 2017, (dymije e shtatembedhjete), ditën e hazretare, perpara meje noteres Donika Gjini, ne zyren time ne adresen Blv.B.Curri, Tirane, u paraqiten palet e meposhtme:

**Genci HAFIZI**, i lindur me 10-02-1958 ne Lezhe, i biri i Ramiz-it, banues ne Shkoder, Rr. "Qemal Dracini", L. "Vasil Shanto", Pallati prane diskotekes, mbajtes i leternjoftimit nr.024584722, madhor dhe me zotesi te plote per vepruar (*ketu e me poshte ne kete Kontrate referuar si "Shitesi"*).

**Alma HAFIZI**, e lindur me 22-06-1969 ne Shkoder, e bija e Zija-se, banuese ne Shkoder, Rr. "Qemal Dracini", L. "Vasil Shanto", Pallati prane diskotekes, mbajtese e leternjoftimit nr.024584170, madhor dhe me zotesi te plote per vepruar (*ketu e me poshte ne kete Kontrata ne cilesine e bashkeshortes se Shitesit*).

**Hasan HAFIZI**, i lindur me 11-02-1955 ne Lezhe, i biri i Ramiz-it, banues ne Tirane, Rr. "Sami Frasheri, P.19/1" mbajtes i leternjoftimit nr.029055631, madhor dhe me zotesi te plote per vepruar (*ketu e me poshte ne kete Kontrate referuar si "Bleresi"*);

*"Genci HAFIZI" dhe "Alma HAFIZI" si dhe "Hasan HAFIZI" ketu e me poshte ne kete Kontrate Per Kalimin e Kuotes se Kapitalit (ketu e me poshte ne kete Kontrate referuar si "Kontrata"), se bashku do te referohen ne vijim si "Palet".*

**MEQENESE**

- A. Shitesi zoteron 858 kuota me vlere nominale 82.000 Leke secila secila (ose 52% te kuotes me vlere te pergjithshme 70.356.000 Leke) (me poshte "Kuotat e Shitesit") ne kapitalin e ALBAVIA SHPK., shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, regjistruar me nr. J81527001Q ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Republikes se Shqiperise, me seli ne Tirane, Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk.1, ap.19 (me poshte e quajtur "Shoqeria"), me kapital 135.300.000 Leke, ndare ne 1.650 kuota me vlere nominale 82.000 Leke secila.
- B. Shitesi deshiron te kaloje pronesine mbi te gjitha Kuotat e Shitesit te identifikuar ne paragrafin (A) me siper, dhe Bleresi i pranon ato.

Ne konsiderate te sa me lart, Palet bien dakort per sa vijon:



## **NENI 1**

### **KALIMI I PRONESISE**

- 1.1 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Shitesi i kalon Bleresit dhe Bleresi pranon nga Shitesi te gjitha Kuotat e Shitesit dhe çdo te drejte te lidhur me to dhe/ose qe rrjedh prej tyre.
- 1.2 Me nenshkrimin e Kontrates, pronesia mbi te gjitha Kuotat e Shitesit dhe te drejtat e tjera qe lidhen me to dhe ose rrjedhin prej tyre, perfshire te drejten e votes dhe te dividetit si dhe te drejtat ne administrimin e Shoqerise i kalon Bleresit dhe Shitesi zhvishet teresisht prej tyre.

## **NENI 2**

### **ÇMIMI I SHITJES DHE MENYRA E PAGESES**

- 2.1 Palet bien dakort qe marredheniet e tyre financiare ne lidhje me kalimin e pronesise se kuotes se Shitesit jane rregulluar sipas Akt Marreveshjes qe palet kane lidhur ndermjet tyre.

## **NENI 3**

### **DEKLARIME DHE GARANCI**

- 3.1 Shitesi deklaron dhe garanton se ka te drejte dhe nuk ka asnje pengese te çfaredo natyre qe te lidhe dhe zbatoje kete Kontrate dhe se kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe per Shitesin.
- 3.2 Bleresi deklaron dhe garanton se ka te drejte dhe nuk ka asnje pengese te çfaredo natyre qe te lidhe dhe zbatoje kete Kontrate dhe se kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe per Bleresin. Gjithashtu, Bleresi i pranon Kuotat e Shitesit objekt i kesaj Kontrate ne gjendjen te cilat ato jane dhe nuk ka asnje pretendim ne lidhje me to apo te drejta qe lidhen me to dhe/ose rrjedhin prej tyre.

## **NENI 4**



### **TE NDRYSHME**

- 4.1 Secila prej paleve do te perballoje shpenzimet e veta ne lidhje me negocimin, nenshkrimin dhe permbushjen e detyrimeve te parashikuara ne kete akt.
- 4.2 Asnje ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete i vlefshem nese nuk behet me shkrim dhe nenshkruhet personalisht nga palet e kesaj Kontrate apo perfaqesues te autorizuar rregullisht prej seciles nga palet ne fjale.

## **NENI 5**

### **LIGJI ZBATUES DHE ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE**

- 5.1 Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete akt apo qe mund te rrjedhin prej saj do te zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Kontrate.






5.2 Çdo mosmarrveshje qe mund te linde midis paleve te ketij akti ne lidhje me zbatimin apo interpretimin, nese nuk zgjidhet ne mirekuptim mes vete paleve, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Une Noteri, e lexoj tekstin e ketij akti me ze te larte dhe te kuptueshem paleve te cilet, pasi me deklaruan se teksti i ketij akti eshte ne perputhje te plote me theniet dhe vullnetin e tyre, e nenshkruajne ate rregullisht ne pranine time ne 4 (kater) origjinale me vlere te njejte secili, dhe une Noteri vertetoj sa me siper sipas ligjit ne fuqi.


**BLERESI**



**Hasan HAFIZI**




**SHITESI**



**Genci HAFIZI**

**Dha Pelqimin**



**Alma HAFIZI**

**NOTER**

